


FLETË INFORMUESE

Hartëzimi i Presioneve në Parkun
Kombëtar të lumit Vjosa



Informacion i përgjithshëm

Parku Kombëtar i Lumit Vjosa (PKLV) u shpall më 13 mars 2023, i cili përbën parkun e parë dhe të vetëm të një lumi të egër në Evropë.



Ai shtrihet në jug të Shqipërisë, përmes qarqeve Fier, Vlorë dhe Gjirokastër, duke përfshirë lumin Vjosa dhe degët e tij kryesore si Drino, Shushica dhe Bënça. Zona e parkut mbulon një sipërfaqe prej 12,727 hektarësh, nga të cilat 6,030 hektarë (47.3%) janë sipërfaqe ujore, 4,593 hektarë (36.1%) janë zona bregdetare dhe fusha lumore, 1,199 hektarë (9.5%) janë sipërfaqe toke dhe 905 hektarë (7.1%) janë tarraca lumore të ekspozuara ndaj erozionit.

Lumi i Vjosës përfaqson një tipologji unike. Çelësi i biodiversitetit të jashtëzakonshëm të Vjosës qëndron në dinamikën e tij hidro-morfologjike, veçanërisht në vazhdimësinë gjatësore të rrjedhës së ujit ("regjimi i rrjedhës natyrore"), i cili mbetet i paprekur në të gjithë gjatësinë e lumit që përbën vlerën kryesore të Parkut. Përmbytjet dhe transporti i lartë i sedimentit krijon një mozaik habitatesh dhe ekosistemesh unike.

Në këtë park përfshihen gjithashtu 47 burime me prurje të qëndrueshme, ndër të cilat burimet më të mëdha janë Burimi i Këlcyrës, Uji i Ftohtë (Tepelenë) dhe Syri i Kaltër (Sarandë). Prurjet natyrore të lumit Vjosa janë të ndikuara nga aktivitetet antropogjene që ndodhin përgjatë gjithë shtratit të tij.

Në vlerësimin e fundit të realizuar nga EcoAlbanian në kuadër të Fushatës “Të shpëtojmë zemrën blu të Evropës”, janë identifikuar, hartëzuar dhe vlerësuar presionet kryesore mbi hidromorfologjinë dhe biodiversitetin e lumit Vjosa dhe të degëve të tij, Disa prej presioneve kryesore të vlerësuara janë:



Marrja – Nxjerrja e ujit: Nxjerrja e ujit për vaditje, furnizim urban dhe përdorim industrial është një problem kryesor që ndikon negativisht në prurjet e Vjosës, sidomos gjatë sezonit të thatë duke kërcënuar habitatet ujore dhe tokësore.



Marrja – Nxjerrja e zhavorit nga lumi: Nxjerrja dhe përpunimi i inerteve lumore (zhavorri) rezulton industri aktive dhe e shpërndarë përgjatë gjithë rrjedhës së Parkut Kombëtar. Shkakton degradim të peizazhit dhe dëmton vegjetacionin breglumor.



Nxjerrja e naftës: Në Bashkinë e Selenicës, aktiviteti i kërkimit dhe prodhimit të naftës përfaqëson një nga presionet kryesore industriale, me ndikim potencial mbi ekosistemet përreth, përfshirë edhe lumin Vjosa.



Nxjerrja dhe përpunimi i bitumit: Shkarkimet e materialeve të gërmuara ndikojnë thellësisht integritetin ekologjik të lumit dhe biotën, pasi ndër të tjera, këto përmbajnë metale të rënda.



Mbetjet urbane: Mbetjet urbane përfaqësojnë një nga presionet kryesore mjedisore në basenin e Vjosës, për shkak të grumbullimit të pjesshëm, mungesës së planeve të menaxhimit dhe derdhjes së tyre të pakontrolluar në lumë, veçanërisht në zonat rurale.

Shihet me rëndësi adresimi i këtyre presioneve me qëllim shmangien e ndikimeve negative apo minimizimin e presioneve ndaj parkut, në përputhje me Planin e Menaxhimit të PKLEV.

Marrja – Nxjerrja e ujit

Nxjerrja e ujit për vaditje, furnizim urban dhe përdorim industrial është një ndër problemet kryesore. Përdorimi i ujërave për vaditje që kryhet përmes kanaleve vaditëse, në bazë të të dhënave të mbledhura në raport, përfshijnë të paktën një sipërfaqe prej 47,266 hektarësh. Reduktimi i prurjeve gjatë sezonit të thatë ndikon drejtpërdrejt në habitatet ujore dhe tokësore, duke kompromentuar mbijetesën e specieve të ndjeshme. Për më tepër, ujërat nëntokësore të basenit të Vjosës përdoren në mënyrë intensive për qëllime bujqësore dhe industriale.

Në funksion të vaditjes, një numër sistemesh pompimi ushqejnë me ujë kanalet ujitëse, por nuk disponohen të dhëna të sakta për numrin e tyre. Disa prej kanaleve operojnë me rrjedhje të lirë. Një numër i papërcaktuar digash dhe pritash janë ngritur në anë të brigjeve për të mbrojtur erodimin e tokave prej vërshimeve apo prej përmytjeve.

Një pjesë infrastrukturës për ujitje është **jashtë funksionit**, përfshirë edhe disa stacione pompimi. Psh, kanali ujitës Vjosë-Levan-Fier, punon me gjysmën e kapacitetit. Bashkitë nuk disponojnë të dhëna mbi volumin e sedimenteve, madje edhe të dhënat mbi volumin e ujit i kanë teorike, mbi bazën e paramentrave teknike të pajisjeve të pompimit, por nuk janë në gjendje që të përlllogarisin një konsum të përgjithshëm vjetor.

Aktivitetet kryesore janë përqendruar **në ultësirat e Fierit dhe Gjirokastrës**, si pasojë vihen re prurje të ulëta në rrjedhën e poshtme të lumit si pasojë e marrjes së ujit për vaditje dhe përdorime industriale.



Kanali Vaditës Vjosë-Levan-Fier © A. Rama

Rekomandime:

- Të llogaritet sasia e përgjithshme e ujit që nxirret nga akuiferet e Vjosës dhe të kontrollohet volumi i shfrytëzimit për përdorime shtëpiake, bujqësore dhe industriale.
- Përdorimi i ujit të bëhet pa kompromentuar integritetin ekologjik të parkut, duke marrë parasysh edhe ndikimet nga ndryshimet klimatike.
- Në Luginën e Drinos, të bëhet një vlerësim i ndikimeve nga aktivitetet ekonomike që përdorin akuiferet e zonës.

Marrja – Nxjerrja e zhavorrit nga lumi

Nxjerrja e inerteve lumore (marrja e zhavorrit), ka të bëjë me intensitetin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese, e cila rezulton aktive dhe e shpërndarë përgjatë gjithë rrjedhës së Parkut Kombëtar. Pasojat e këtij aktiviteti duken, kryesisht, pranë brigjeve dhe rrjedhës së lumit. Këto “pika të nxehta” edhe pse gjenden larg qendrave të banuara dhe në distancë nga njëra-tjetra, shkaktojnë ndikime pamore dhe degradim të peizazhit në një shkallë të moderuar, por sidoqoftë në varësi të karakteristikave fizike, distancës nga shtrati dhe veçorive të peizazhit në të cilin janë vendosur.

Rrugët e hapura për depozitimin e zhavorrit (gjatë një periudhe, rreth tridhjetëvjeçare) e kanë shtuar dëmin. Të tjera ndikime shtesë janë shkaktuar edhe nga mungesa e menaxhimit të mbetjeve ndërtimore, prej të cilave janë krijuar kodrina të vogla mbi sipërfaqe, duke dëmtuar vegjetacionin breglumor, ndërkohë që të tjera kodrina, me një impakt më të madh, janë vendosur drejtpërdrejt në shtratin e rrjedhës.



Harta e shpërndarjes së minierave dhe guroreve më të rëndësishme pranë brigjeve të Vjosës

Zona më e prekur e shtratit të Vjosës është ndërmjet Selenicës dhe Këlcyrës ku aktivitetet e marrjes së zhavorrit janë më të përhapura. Megjithatë ky aktivitet shprehet i përhapur edhe në degët e saj si Drino, Shushica dhe Bënça. Këto aktivitete kanë ndikim të madh mbi morfologjinë e lumit dhe integritetin e habitateve përreth.

Në total janë identifikuar 36 impiante të zhavorrit dhe fraksionimit të inerteve që shkaktojnë dëmtim të habitateve natyrore, ndryshime në dinamikën e sedimentit dhe prurjet e ujit. Vrojtimet në terren tregojnë se pjesa më e madhe e impianteve dhe aktiviteteve për marrjen dhe përpunime zhavorrit janë aktive (17), përgjatë gjithë territorit të Parkut Kombëtar. 5 prej tyre janë jo aktive, 5 të braktisura dhe vetëm 2 prej tyre të rehabilituara.



Impiant i fraksionit të materialeve inerte, në anë të Vjosës (Tepelenë) © A. Rama

Rekomandime:

- Të kryhet një studim mbi efektet kumulative të marrjes së zhavorrit dhe ndikimin e tij mbi biodiversitetin.
- Të monitorohen aktivitetet e marrjes së zhavorrit dhe të rehabilitohen zonat e dëmtuara përmes ripërtëritjes së vegjetacionit riparian.
- Të largohen depozitimet ilegale të inerteve pranë brigjeve dhe të ndalohen depozitimet e reja.

Nxjerrja e naftës

Aktivitetet industriale përfshijnë nxjerrjen e naftës, bitumit, gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera. Aktivitetet industriale shkaktajnë ndotje kimike, dëmtim të habitateve natyrore dhe ndryshime të cilësisë së ujërave. Në seksionin e mesëm të Vjosës midis Selenicës dhe Mallakastrës janë aktive rreth 150 puse naftë, pjesa më madhe e të cilëve edhe pse janë lokalizuar në distancë nga Parku Kombëtar, here pas here shkaktajnë ndotje të drejtpërdrejtë në ujë për shkak të rrjedhjeve të pakontrolluar të naftës bruto. Në Bashkinë e Selenicës bëhet kërkimi dhe prodhimi i hidrokarbureve, i cili përfaqësohet nga vendburimi i naftës në zonën Gorisht-Kocul Amonicë dhe Karbunarë, që ndodhet mes hapësirës rurale ndërmjet Luginës së Vjosës (lindje) dhe Luginës së Shushicës (perëndim). Nga këto meriton vemëndje zona Gorisht-Kocul me mbi 150 puse aktive, me thellësi nga 700m deri në 1500m, të shpërndara në një sipërfaqe, prej 6 km², ku pika më e afërt e presionit industrial më shtratin e lumit ndodhet në një distancë prej 1300m larg Vjosës në afërsi të Poçemit.



Stacioni i Naftës Gorisht (Albpetrol Sh.a) © Joshua David Lim

Nxjerrja dhe përpunimi i Bitumit

Minierat dhe guroret përbëjnë një kërcënim për biodiversitetin ujor të lumit. Shkarkimet e materialeve të gërmuara ndikojnë thellësisht integritetin ekologjik të lumit dhe biotën, pasi ndër të tjera, këto përmbajnë metale të rënda. Numri i përgjithshëm i minierave në luginën e Vjosës sipas AKBN është **43** dhe klasifikohen që të gjitha si jometalore. Nga vlerësimi i kombinuar edhe me kontrolle në terren, rezulton se Bashkia e Selenicës ka numrin më të lartë, **me 13 miniera, 8 prej të cilave ndodhen në qytetin e Selenicës** dhe shfrytëzojnë mineralin e bitumit dhe zhavorrin bituminoz. Ato janë përqëndruar në një sipërfaqe, rreth **3.4 km²** në lindje të qytetit, ku pikat e shfrytëzimit afrohen deri **100m në bregun e lumit**.

Gjithashtu **5 miniera të tjera** (Gur gëlqeror) ndodhen në Malin e Bratit dhe ndahen mes Lepenicës dhe Bratajt. Këto ndodhen në një distancë, relativisht të madhe nga bregu, por ato të Lepenicës kanë një ndikim më të dukshëm në peizazh, veçanërisht gjatë shpërthimeve, ku një re e madhe tymi ngrihet në ajër, çka vihet re që poshtë.



Minierë bitumi në Selenicë që depoziton mbetjet në brigjet e lumit Vjosa © Joshua David Lim



Minierë bitumi në Selenicë që depoziton mbetjet në brigjet e lumit Vjosa © Artan Rama

Presioni më i lartë gjendet në seksionin Selenicë-Poçëm. Këto Miniera ndikojnë negativisht në cilësinë e ujërave dhe tokave përreth.

Rekomandime:

- Të ngritet një sistem monitorimi përmes të cilit të realizohet kontrolli i shkarkimeve tokë-ujë-ajër, për të garantuar mbrojtjen e integritetit ekologjik të Parkut Kombëtar të Vjosës.
- Të hartohet një plan veprimi për rehabilitimin e habitateve të degraduara dhe të ndalohen depozitimet e mëtejshme të mbetjeve industriale.
- Të eliminohen dampat e mineraleve pranë brigjeve të lumit në Selenicë dhe të rehabilitohen brigjet e dëmtuara.

Presionet nga depozitimi i mbetjeve urbane

Bashkitë përgjatë lumit Vjosa dhe degëve të tij përballen me një sërë sfidash mjedisore që lidhen kryesisht me menaxhimin e mbetjeve urbane, ujërave të ndotura dhe zhvillimin e pakontrolluar të territorit.

Shumë prej venddepozitimeve të mbetjeve janë të paautorizuara dhe pa leje mjedisore, duke ndikuar drejtpërdrejt cilësinë e ujërave të lumit. Grumbullimi i mbetjeve është i pjesshëm dhe joefikas, me një pjesë të madhe të fshatrave që nuk mbulohen nga shërbimi dhe që i hedhin mbetjet në shtratin e Vjosës. Vetëm një e treta e bashkive kanë plane menaxhimi për mbetjet, dhe kompostimi mungon plotësisht në të gjithë basenin, pavarësisht karakterit rural të zonës. Ujërat e ndotura, si në qytete ashtu edhe në zona rurale, derdhen pa asnjë trajtim në lumë, pasi mungojnë impiantet e trajtimit. Rrjetet e kanalizimeve janë të dëmtuara ose të papërfunduara, çka shkakton bllokime dhe derdhje të drejtpërdrejtë në natyrë. Ndërtimet informale, mungesa e planifikimit urban dhe afërsia e infrastrukturës rrugore me shtratin e lumit përkeqësojnë më tej situatën, sidomos në zonat e ngarkuara si hyrjet në Tepelenë, Memaliaj, Novoselë apo segmentet urbane të Këlcyrës. Në këto zona vërehet një degradim i peizazhit dhe rritje e ndërtimeve pa standarde arkitektonike. Në kontrast me to, pjesa e sipërme e lumit dhe degët si Shushica e Sipërme ruajnë ende karakterin natyror, megjithëse ka shenja të zhvillimit të shpejtë turistik që mund të kthehen në presion në të ardhmen. Gjendja aktuale kërkon masa të menjëhershme për përmirësimin e infrastrukturës mjedisore, forcimin e kontrollit dhe hartimin e planeve të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve dhe urbanizimit përgjatë gjithë rrjedhës së Vjosës.



Kanal për kalimin e ujërave të zeza © Joshua David Lim



Landfill në bashkinë Tepelenë "Majkosh" © Joshua David Lim

Rekomandime:

- Eliminimi i depozitimeve ilegale dhe ndalimi i praktikave të reja të hedhjes së mbetjeve
- Zhvillimi i një sistemi funksional për menaxhimin e mbetjeve urbane
- Monitorim dhe përgjegjshmëri për ndotjen nga mbetjet